



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2022

RELACION

“MBI MIRATIMIN E “PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2023-2025”.

Bashkia Shkodër, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj në fushën e diasporës dhe migracionit, ligjit “Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar Neni 29/1 dhe akteve nënligjorë të tij, Strategjisë Kombëtare për Diasporën Shqiptare, ligjit “Për të huajt”, ligjit “Për shtetësinë”, ligjin nr. 16/2018 ‘Për diasporën”, i ndryshuar; hartoi në bashkëpunim me GIZ (Programi 'Migrimi dhe diaspora'), draftin e “Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025”.

Ky dokument është i një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh situatën aktuale, në të cilën nga njëra anë kemi migracionin gjithnjë në rritje drejt vendit tonë, si dhe migrantët e kthyer, si një komunitet me nevoja emergjente, të cilit duhet ti kushtohet vemendja e duhur për të arritur një ri-integrim të qëndrueshëm të tij, nga ana tjetër qëndron diaspora, e cila është një resurs i jashtëzakonshëm intelektual dhe ekonomik, si dhe potencial konkret për zhvillimin e vendit.

Diaspora shkodrane është një mundësi e madhe për zhvillimin e vendlindjes. Ky Plan veprimi synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i Diasporës. Qëllimi është që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendlindjes. E gjithë kjo do të realizohet me një proces rivlerësimi të marrëdhënies me Diasporën si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e vet në qytetin e origjinës dhe anasjelltas.

Sa më sipër “Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025”, përbën një plan masash konkrete, të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e migracionit dhe diasporës, të cilat garantojnë përmbushjen e projekteve prioritare për integrimin e tyre dhe përfshirjen në jetën social ekonomike të Bashkisë Shkodër.

Me miratimin e këtij plani synohet gjithashtu incentivimi i investimeve nga diaspora në komunitetet e tyre të prejardhjes, si dhe organizatave ndërkombëtare, nëpërmjet implementimit të projekteve të përbashkëta, me qëllim zhvillimin social-ekonomik të qytetit.

“Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025” është një dokument i rëndësishëm, i cili pasqyron detajimin e funksioneve bazë të sektorëve të ndryshëm të bashkisë, për përmbushjen e detyrave të saj funksionale, duke e shndërruar bashkinë në një portë të hapur për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës shkodrane në jetën ekonomike dhe social-kulturore të qytetit, si dhe një suport dhe ndihmë konkrete për migrantët e kthyer.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETAR
BARDH SPAHIA**



Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Riduan Sokoli *Riduan Sokoli*